



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
FORUMI PËR TRANSPARENÇË PARLAMENTARE**

PLANI I VEPRIMIT
Për Kuvend të hapur dhe transparent
2016-2020

Qershor 2016
Prishtinë

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
1. QASJA NË INFORMATA PARLAMENTARE	7
1.1 Zbatimi i udhëzimit administrativ për publikimin e informatave parlamentare nga Kuvendi	9
1.2 Sigurimi i cilësisë së mirë të përkthimit në gjuhët zyrtare dhe publikimi në kohë optimale për dokumentet e Kuvendit	10
1.3 Publikimi i të dhënave për deputetët si dhe të dhëna për aktivitetet e tyre	11
1.4 Publikimi i punës së trupave të Kuvendit, kryesisë dhe komisioneve Parlamentare	12
1.5 Krijimi i sistemit elektronik për përcjelljen e legjislacionit	13
1.6 Hartimi i përmbledhjeve të thjeshta dhe lehtë të kuptueshme të informatave parlamentare	14
1.7 Lehtësimi i qasjes në regjistrin e votave të deputetëve	14
1.8 Publikimi i dokumenteve në format të hapur (XML etj.) të cilat mund të ripërdoren nga palët e interesuara	15
2. PJESËMARRJA E QYTETARËVE DHE SHOQËRISË CIVILE NË PUNËT E KUVENDIT	17
2.1 Rishikimi i Rregullores për qasje të mediave dhe publikut në punët e Kuvendit	18
2.2 Avancimi i kushteve për të lehtësuar qasjen dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara	19
2.3 Avancimi i procedurave dhe praktikave për pjesëmarrjen e OSHC-ve dhe qytetarëve në dëgjimet publike të Komisioneve	20
2.4 Biblioteka dhe arkivi të bëhen të qasshme për studiues dhe hulumtues të dokumentacionit parlamentar	21
2.5 Zgjerimi dhe avancimi i qendrës së vizitorëve në Kuvend	21
2.6 Hartimi dhe miratimi i tekstit mbi politikën e privatësisë së të dhënave për përdoruesit e ueb-faqes së Kuvendit	23
3. LLOGARIDHËNIA	25
3.1 Rishikimi i kodit të mirësjelljes në raport me parimet dhe standardet ndërkombëtare për etikë parlamentare	26
3.2 Avancimi i transparencës buxhetore	27

4.1 Funksionalizimi i plotë i platformës së “E-parlamentit” dhe zhvillimi i databazës online i shënimeve origjinale të Kuvendit (e-parlamenti me arkivë elektronike)	30
4.2 Ri-dizajnimi i uebfaqes së Kuvendit me “Responsive Web Design” dhe funksionalizimi i sistemit të integruar për incizime dhe emetim (web-casting) audio/video të seancës plenare, mbledhjeve të komisioneve dhe aty ku mund të aplikohet	31
4.3 Ri-strukturimi i tërë databazës (ueb faqes) që të mundësohet qasje intuitive në përmbajtje	33
4.4 Analiza e mundësisë edhe për kalimin në “Cloud” dhe të përdorimit të “open source” në rastet ku mund të aplikohet konform kërkesave teknologjike	34
4.5 Krijimi i platformës për E-pjesëmarrje dhe rregullimi me një Rregullore të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës	35

Ky dokument paraqet Planin e Veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zbatimin e Deklaratës për Parlament të Hapur, të miratuar nga Kryesia e Kuvendit në Maj të vitit 2015. Me hartimin dhe zbatimin e këtij plani, Kuvendi synon të konkretizoj masat të cilat do të ndërmerren me qëllim që Kuvendi gradualisht të arrijë parime dhe standardet e transparencës parlamentare që promovon Deklarata. Ky plan synon të shërbej si udhërrëfyes për Kuvendin në përpjekjet për të promovuar kulturën e transparencës, për të siguruar qasjen e lehtë dhe me kohë në informatat që ndërlidhen me punën e deputetëve, si dhe vënien në zbatim të teknologjisë informative për të rritur ndërveprimin në mes të Kuvendit dhe qytetarëve.

Plani i veprimit është përgatitur nga Forumi për Transparencë Parlamentare, i cili u themelua nga Kryesia e Kuvendit, të shërbej si organ këshilldhënës në çështjet që ndërlidhen me transparencën dhe llogaridhënien institucionale. Plani është përgatitur në disa sesione punuese ku morën pjesë përfaqësues të grupeve parlamentare, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe zyrtarë të administratës së Kuvendit. Gjatë përgatitjes së planit anëtarët e Forumit janë mbështetur nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), të cilët kanë vënë në dispozicion përvojën në përgatitjen e planeve të ngjashme në parlamentet e Ukrainës dhe Gjeorgjisë.

Para se të nis hartimi i planit të veprimit, një grup punues në kuadër të Forumit ka bërë një analizë të hollësishme për të vlerësuar se ku qëndron aktualisht Kuvendi në përmbushjen e parimeve dhe standardeve që promovon Deklarata për Parlament të Hapur. Ky vlerësim ka ndihmuar anëtarët e Forumit në përcaktimin e 22 veprimeve/masave konkrete për të avancuar transparencën parlamentare dhe për të promovuar ndërveprimin e qytetarëve me Kuvendin. Plani përcakton objektivat specifike që duhet të arrihen, veprimet konkrete që duhet të ndërmerren nga Kuvendi si dhe institucionet e organizatat partnere të Kuvendit.

Plani i veprimit do të jetë pjesë e planit strategjik afatgjatë të Kuvendit, nga i cili do të burojnë planet vjetore ku do të përcaktohen edhe implikimet buxhetore. Forumi për transparencë parlamentare do të sigurohet që implikimet buxhetore të pasqyrohen në buxhetin e Kuvendit për vitet e ardhshme, dhe do të mbikëqyrë zbatimin e planit të veprimit. Me miratimin e Deklaratës për Parlament të Hapur dhe hartimin e zbatimin e Planit të Veprimit, Kuvendi i Kosovës synon të jetë lider për tërë rajonin sa i përket transparencës parlamentare. Puna e deritanishme pritet ti shërbej Forumit për transparencë parlamentare që të intensivizoj përpjekjet për anëtarësimin e Kuvendit në grupin punues për transparencë parlamentare, në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP).

1. QASJA NË INFORMATA PARLAMENTARE

Publikimi i informatave parlamentare lejon qasjen e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në informatat që kanë të bëjnë me punën e parlamentit. Përmes publikimit të informatave parlamentare avancohet transparenca dhe inkurajohet pjesëmarrja aktive e qytetarëve në procesin ligjvënës, duke forcuar kështu rolin e Kuvendit si institucion. Me miratimin e Deklaratës për Parlament të Hapur, Kuvendi është zotuar që të rrisë qasjen e qytetarëve në punën e Kuvendit. Në muajin Mars të vitit 2016 është nxjerrë Udhëzimi Administrativ për publikimin e dokumenteve të Kuvendit, i cili përcakton se cilat dokumente janë të qasshme dhe afatet kohore për publikimin e tyre. Publikimi i projektligjeve gjatë fazës së shqyrtimit në Kuvend ka qenë një e arritur e rëndësishme për Kuvendin. Megjithatë, për të rritur nivelin e përfshirjes së qytetarëve në procesin ligjvënës është shumë e rëndësishme që ata të kenë mundësi jo vetëm të lexojnë projektligjet por edhe të mund të dërgojnë komentet dhe sugjerimet e tyre. Për të rritur nivelin e përfshirjes së publikut, Kuvendi synon të funksionalizoj sistemin elektronik për përcjelljen e legjislacionit, ku qytetarët të kenë mundësi për tu përfshirë aktivisht në procesin ligjvënës. Në rastin e propozimeve legjislative, çdo propozim i regjistruar nga Kuvendi do të postohet automatikisht në ueb faqe ku qytetarët do të kenë mundësi të japin komentet e tyre edhe në mënyrë elektronike. Gjithashtu, publikimi i regjistrimit të votave të deputetëve në seancat plenare, është ndër të arriturat më të mëdha në aspekt të transparencës, mirëpo që duhet të avancohet tutje duke e bërë më të lehtë qasjen. Në këtë drejtim, Kuvendi parasheh publikimin në kohë të informatave parlamentare si: të dhënat për deputetët, raportet vjetore, planet e punës, procesverbalet, transkriptet, si dhe vendimet e Kuvendit, Kryesisë dhe komisioneve.

1.1 Zbatimi i Udhëzimit Administrativ për publikimin e informatave parlamentare nga Kuvendi

Situata aktuale:	Në Mars të vitit 2016 është miratuar Udhëzimi Administrativ për publikimin e informatave parlamentare të Kuvendit, i cili përcakton dokumentet që duhet publikuar nga Kuvendi, zyrtarët përgjegjës si dhe afatet kohore.
Masat/Veprimet:	<ol style="list-style-type: none"> 1.Përcaktimi i metodologjisë dhe organit përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Udhëzimit. 2.Organizimi i takimeve tremujore me udhëheqësit e Administratës së Kuvendit për të adresuar problemet në postimin e dokumenteve në ueb. 3.Publikimi i informatave kontaktuese të zyrtarit përgjegjës për qasje në dokumente publike 4.Trajnimi i personit përgjegjës për qasje në dokumente publike 5.Përgatitja e formularit (kërkesës) për qasje në dokumente publike 6.Publikimi i kërkesave dhe përgjigjeve për qasje në dokumente publike
Afati kohor:	2016 - në vazhdimësi
Departamenti/Personi përgjegjës në Kuvend:	Sekretari i Kuvendit
Organizatrat partnere:	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti GAP, INDEP, Lëvizja FOL, GLPS dhe Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)

1.2. Sigurimi i cilësisë së përkthimit në gjuhët zyrtare dhe publikimi i dokumenteve në kohë optimale

Situata aktuale:	Informatat parlamentare, siç janë procesverbalet dhe transkriptet nuk publikohen në kohë reale për shkak të procedurave të miratimit dhe përkthimit. Planet e punës së Komisioneve nuk publikohen dhe ende ka raste kur Kuvendi nuk i publikon procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve parlamentare. Dokumentet dhe vendimet tjera mund të publikohen në kohe reale.
Masat/Veprimet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zgjerimi i Drejtorisë për shërbimet e përkthimit 2. Publikimi i dokumenteve në kohë optimale, në dy gjuhët zyrtare (Transkriptet, procesverbalet, raportet, vendimet, planet e punës së Komisioneve)
Afati kohor:	2016-2017
Departamenti/Personi përgjegjës në Kuvend:	Drejtorja e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale Shërbimi i Përkthimit
Organizatat partnere:	Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE)

1.3. Publikimi i të dhënave për deputetët	
Situata aktuale:	Sa i përket informatave të deputetëve, në ueb faqen e Kuvendit publikohet lista e deputeteve, grupi parlamentar të cilit i takon, funksionet që mban në Kuvend, të dhënat personale; si data e lindjes, arsimimi, adresa dhe numri kontaktues. Megjithatë, qytetarët nuk mund të gjejnë një CV të detajuar të deputetëve të zgjedhur, e poashtu nuk gjenden as informatat e aktiviteteve të deputetëve, si pyetjet parlamentare, fjalimet, votimet, iniciativat, vizitat dhe takimet, si dhe mungojnë të dhënat e deklarimit të pasurisë së tyre. Qytetarët madje nuk informohen as lidhur me qëndrimet e deputetëve për çështje të caktuara.
Masat/Veprimet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e një formulari uniform të CV-së për secilin deputet, plotësimi dhe publikimi i tij në fillim të mandatit. Në profilin e deputetes/deputetit të krijohet hapësira, linqet që paraqesin të dhënat e aktivitetit të tyre (deklaratat, pyetjet, fjalimet, votimet si dhe raportet e tyre të vizitave brenda dhe jashtë vendit) 2. Në profilin e deputetëve të vendoset vegëza e AKK për deklaratën e pasurisë së saj/tij
Afati kohor:	2016-2018
Deparatmenti/Personi përgjegjës në Kuvend:	Kryesia e Kuvendit Sekretari i Kuvendit
Organizatrat partnere:	Agjensioni Kundër Korrupsionit, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI),

1.4. Publikimi i punës së Kryesisë dhe komisioneve parlamentare

<p>Situata aktuale:</p>	<p>Kuvendi ofron të dhëna për përbërjen e kryesisë dhe një përshkrim të shkurt për punën e tyre, si dhe publikon transkriptet e takimeve të kryesisë, megjithatë nuk publikon për publikun materialet si procesverbalet dhe vendimet e kryesisë. Për më tej, Kuvendi në ueb faqen e tij ofron të dhëna për agjendën ditore apo disa ditore të Kuvendit, informata rreth listës së komisioneve parlamentare, përbërjes si dhe takimet e tyre, megjithatë nuk ofron në dispozicion për publikun planet vjetore të komisioneve parlamentare dhe përmbledhjet nga aktivitetet e tyre.</p>
<p>Masat/veprimet:</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Publikimi i materialit për pikat e rendit të ditës, si dhe procesverbalet dhe vendimet e kryesisë, ndër tjera, edhe vendimet që përfshijnë shpenzimet financiare të Kuvendit 2. Rifreskim i Planit të Punës (agjendës legislative) në baza të rregullta nga Kuvendi dhe orari i seancave dëgjimore. Plani i punës duhet të bëhet në një format interaktiv dhe lehtë të manovrueshëm. 3. Publikimi dhe rifreskimi i vazhdueshëm i planeve vjetore të komisioneve
<p>Afati kohor:</p>	<p>2016-ne vazhdim</p>
<p>Departamenti/Personi përgjegjës në Kuvend:</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale</p>
<p>Organizatat partnere:</p>	<p>Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)</p>

1.5 Krijimi i sistemit elektronik për përcjelljen e legjislacionit	
Situata aktuale:	Në vitin 2011, Kuvendi i Kosovës i përkrahur nga partnerët mbështetës si GIZ, OSCE dhe NDI ka ndërmarr hapa për krijimin e strategjisë për modernizimin e IT-së, pjesë e së cilës është edhe krijimi i sistemit elektronik për përcjelljen e legjislacionit. Me gjithë progresin e arritur në zbatimin e platformës së E-parlamentit, Kuvendi ende nuk ka funksionalizuar plotësisht Sistemin Elektronik për Përcjelljen e Legjislacionit.
Masat/Veprimet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi i softuerit të Sistemit Elektronik për Përcjelljen e Legjislacionit, kompatibel me platformën e E-Parlamentit 2. Zbatimi i Udhëzimit për Publikimin e Dokumenteve 3. Trajnimet/konsultimet me zyrtarët e Drejtorisë së Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedu 4. Lansimi i Sistemit Elektronik për Përcjelljen e Legjislacionit
Afati kohor:	2016
Departamenti/Personi përgjegjës në Kuvend:	Sekretari i Kuvendit Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale Drejtoria e Teknologjisë Informative
Organizatrat partnere:	Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)

1.6 Hartimi i përmbledhjeve të thjeshta dhe lehtë të kuptueshme të informatave parlamentare

Situata aktuale:	Me përjashtim të koncept dokumenteve të ligjeve, që edhe ashtu nuk janë të plotësuara siç kërkohet, nuk ofrohet përmbledhje në gjuhë të thjeshtë për ti vënë në dispozicion informata parlamentare.
Masat/Veprimet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të publikohen memorandumet shpjeguese të projektligjeve. 2. Të përshkruhen dhe publikohen në ueb funksionet e organeve të Kuvendit 3. Të paraqiten diagrame dhe grafika të cilat do të thjeshtojnë përshkrimin e procesit legjislativ.
Afati kohor:	2016-2017
Deparamenti/Personi përgjegjës në Kuvend:	Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale
Organizatrat partnere:	Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI),

1.7. Lehtësimi i qasjes në regjistrin e votave të deputetëve

Situata aktuale:	Kuvendi publikon regjistrin e votave të deputetëve. Megjithatë, kjo është e kufizuar vetëm në votimet elektronike, por jo edhe në rastet kur aplikohen format tjera të votimit, duke përjashtuar votimin e fshehtë. Në rastet e votimit me dorë vështirësohet regjistri i votave, e gjithashtu është e vështirë të sigurohet informatë edhe në rastet kur deputetit i mungon kartela dhe me Rregullore të Kuvendit i lejohet votimi me dorë.
Masat/Veprimet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Digjitalizimi i sallës së seancave 2. Në profilin e deputetëve të krijohet vegëza që lidhet me aktivitetet, çështjet për të cilat ka votuar deputeti. 3. Të sigurohet që votimi elektronik të jetë i obligueshëm edhe në komisione 4. Të regjistrohen edhe votimet në forma tjera si në seanca ashtu edhe në komisione të Kuvendit.
Afati kohor:	2016-2017
Deparamenti/Personi përgjegjës në Kuvend:	Drejtoria e Teknologjisë Informative
Organizatrat partnere:	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti GAP

1.8 Publikimi i dokumenteve në format të hapur (XML etj) të cilat mund të ri-përdoren nga palët e interesuara	
Situata aktuale:	Aktualisht shumë nga informatat parlamentare ipen në format PDF ose të skanuara. Raporti financiar i Kuvendit është i skanuar dhe nuk mundëson përpunimin dhe ri-përdorimin e të dhënave në raport. Deri më tani Kuvendi e ka përgatitur teknikisht sistemin E-PARLAMENT si sistem për punë kolaborative dhe DMS, i cili duhet të mbushet me dokumente reale (ref. urdhëresa për publikim).
Masat/Veprimet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zbatimi i Udhëzimit për publikimin e informatave parlamentare 2. Informatat parlamentare duhet të publikohen në format XML
Afati kohor:	2016 -në vazhdimësi
Deparamenti/Personi përgjegjës në Kuvend:	Sekretari i Kuvendit Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale
Organizatrat partnere:	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti GAP

2. PJESËMARRJA E QYTETARËVE DHE SHOQËRISË CIVILE NË PUNËT E KUVENDIT

Pjesëmarrja qytetare në proceset demokratike është me rëndësi jetike për të promovuar parimet e qeverisjes së hapur. Kuvendi si shtylla kryesore e sistemit demokratik ka rol kyç në promovimin e angazhimit të qytetarëve në zhvillimin e politikave publike dhe shqyrtimin e miratimit të ligjeve. Kuvendi është zotuar të ofroj qasje dhe mundësi të barabartë për pjesëmarrje. Kuvendi ka krijuar bazën e të dhënave të organizatave të shoqërisë civile, e cila përmban informata për profilin dhe fushën e ekspertizës për secilën organizatë dhe ndihmon Kuvendin në mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm me shoqërinë civile. Shoqëria Civile dhe Kuvendi çdo vit mbajnë konferencë të përbashkët duke përcaktuar planin dhe agjendën për vitin pasues, që është në interes edhe të shoqërisë civile. Gjithashtu, OJQ-të e regjistruara në komisionet përkatëse ftohen në fillim të vitit nga kryetarët e komisioneve për të harmonizuar planin e tyre të punës bashkë me OJQ-të. Disa nga OSHC-të zhvillojnë aktivitete të përbashkëta me Komisionet në monitorim të implementimit të ligjeve dhe raportet e tyre janë përdorur nga komisioni gjegjës, por mbetet numër i vogël i OSHC-ve, të cilat bashkëpunojnë me Komisionet në këtë drejtim. Në takimet e seancave plenare, Kuvendi ofron edhe përkthim përmes gjuhës së shenjave për persona me aftësi të kufizuara. Megjithatë, qasja fizike është e kufizuar meqë nuk kanë shtigje për personat me nevoja të veçanta. Poashtu, qasja nuk është e lehtë edhe për studentët të cilët dëshirojnë të përdorin bibliotekën dhe arkivin e Kuvendit, meqë mungojnë dokumente dhe nuk janë të sistemuara. Përpos publikimit të informatave parlamentare, Kuvendi synon të promovoj pjesëmarrjen e sa më shumë organizatave në punën e Kuvendit. Poashtu, duke marrë parasysh rritjen e interesimit të qytetarëve që dëshirojnë të vizitojnë Kuvendinsynohet zgjerimi i Qendrës së Vizitorëve, e cila shërben si hapësirë e parë pritëse për të gjithë vizitorët në Kuvend. Kuvendi në bashkëpunim me Erste Foundation ka nisur organizimin e punëtorive për demokraci, që synon të edukojë gjeneratat e reja të kuptojnë më drejtë demokracinë dhe rolin e Kuvendit. Gjithashtu, Kuvendi synon të nxisë pjesëmarrjen e studentëve për studime parlamentare duke pasuruar bibliotekën me libra fizik dhe elektronik, si dhe të unifikoj dokumentet dhe të digjitalizoj arkivën.

2.1. Rishikimi i Rregullores për qasje të mediave dhe publikut në punët e Kuvendit

Situata aktuale:	Qasja e mediave në punën e Kuvendit është e përcaktuar me rregullore të veçantë të Kuvendit. Në çdo fillim vit, bëhet akreditimi i mediave që mbulojnë punën e Kuvendit, duke u siguruar atyre qasje të plotë në përcjelljen e takimeve të Kryesisë, komisioneve parlamentare dhe seancës plenare. Në takimet e seancave plenare, kabinat të cilat janë të vendosura për media nuk përdoren përpos nga televizioni nacional, dhe të tjerat media marrin sinjalin e njejtë. Një e veçantë e qasjes së mediave në punën parlamentare mbeten mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit të cilat janë të hapura, por ekziston një kufizim i përcjelljes gjatë gjithë kohës, për shkak të mungesës së hapësirës së mjaftueshme.
Masat/Veprimet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rishikimi i Rregullores për qasjen e mediave dhe publikut në punën e Kuvendit, për të garantuar qasje më të lehtë të mediave në punën e organeve të Kuvendit. 2. Publikimi i vendimeve të kryesisë në ueb faqen e Kuvendit.
Afati kohor:	Dhjetor2016
Departamenti/Personi përgjegjës në Kuvend:	Kryetari dhe Kryesia e Kuvendit Forumi për Transparencë Parlamentare Nën-Komisioni për Rregullore, Mandate dhe Imunitet Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale
Organizatat partnere:	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti GAP, INDEP, Lëvizja FOL, GLPS dhe Instituti Kombëtar Demokratik (NDI).

2.2 Lehtësimi i qasjes dhe pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara

Situata aktuale:	Për seancat plenare Kuvendi ofron përkthim përmes gjuhës së shenjave për persona me aftësi të kufizuara. Megjithatë, në aspektin e qasjes fizike në Kuvend ende ka kufizime, meqë të gjitha hyrjet janë me shkallë dhe nuk kanë shtigje për personat me nevoja të veçanta.
Masat/Veprimet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të krijohet infrastruktura adekuate për qasje të personave me aftësi të kufizuara. 2. Të ftohen organizatat për persona me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë aktive në punët e komisioneve, në rastet kur shqyrtohet çështje me interes për këtë kategori.
Afati kohor:	2016 - 2018
Departamenti/Personi përgjegjës në Kuvend:	Drejtoria për Administratë Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun
Organizatrat partnere:	Handikos, Handicap Kosova, Insituti Demokratik i Kosovës (KDI)

2.3. Avancimi i procedurave dhe praktikave për pjesëmarrjen e OSHC-ve dhe qytetarëve në seancat dëgjimore (ligjvënëse dhe mbikëqyrëse) të komisioneve

<p>Situata aktuale:</p>	<p>Baza e të dhënave për angazhim të shoqërisë civile në Kuvendin e Kosovës ka profilizuar organizatat e regjistruara të cilat përcjellin punën e komisioneve parlamentare. Përmes këtij profilizimi OSHC-të e regjistruara pranojnë agjendën e takimeve bashkë me materialet përcjellëse, në mënyrë automatike nga komisionet parlamentare. Kalendari i takimeve i komisioneve parlamentare është i hapur në ueb faqen zyrtare të Kuvendit, dhe grupet e interesit duhet të paraqesin kërkesën tek komisionet përkatëse për pjesëmarrje.</p> <p>Përderisa qasja lejohet për mediat dhe monitoruesit e akredituar në seanca dhe komisione, qasja është më e vështirë për qytetarë që shprehin interes për të përcjellur një çështje të caktuar. Qytetarët njoftohen për takime të komisioneve përmes faqes së internetit të Kuvendit, dhe komunikatës për media që lëshon zyra për informim. Çdo person legjitimohet në hyrje të Kuvendit nga sigurimi dhe ka raste kur ndalohet të hyjë për të përcjellë një mbledhje të Kuvendit në rast se nuk ka pranuar ndonjë email apo ftesë për atë takim/mbledhje.</p>
<p>Masat/Vepimet:</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zbatimi i Manualit për Seancat Dërgjimore të komisioneve 2. Rishikimi i rregullave dhe procedurave për të mundësuar qasjen e qytetarëve dhe OSHC-ve në seancat dëgjimore të komisioneve
<p>Afati kohor:</p>	<p>2016-2017</p>
<p>Deparamenti/Personi përgjegjës në Kuvend:</p>	<p>Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun</p>
<p>Organizatrat partnere:</p>	<p>Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti GAP dhe Lëvizja FOL</p>

2.4. Biblioteka dhe arkivi të bëhen të qasshme për studiues dhe hulumtues të dokumentacionit parlamentar

Situata aktuale:	Biblioteka dhe arkivi i Kuvendi të Kosovës është i hapur, me kërkesë të palës së interesuar. Palët e interesuara mund të bëjnë kërkime dhe të pajisen me informata që i disponon arkivi dhe biblioteka. Arkiva e lajmeve dhe informatave mbi deputetët është funksionale, me përjashtim të procesverbaleve të cilat janë vështirë të qasshme. Biblioteka ka një lokacion të papërshtatshëm për lexuesit, ka mungesë të hapësirës dhe është vështirë e qasshme, si dhe duhet të pasurohet me libra fizik dhe elektronik. Në arkiv, mungon unifikimi i dokumenteve, si dhe digjitalizimi i arkivës. Meqë transmetimi i drejtpërdrejtë bëhet nga televizioni publik, nuk ka arkiv të videove apo në internet kurse mungon një kanal i veçantë i Kuvendit, vetëm në raste të caktuara bëhet edhe në youtube.
Afati kohor:	2017-2020
Departamenti/Personi përgjegjës në Kuvend:	Sekretari i Kuvendit Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale
Organizatrat partnere:	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)

2.5. Zgjerimi dhe avancimi i Qendrës së Vizitorëve në Kuvend

Situata aktuale:	Në shtator të vitit 2012, për herë të parë është hapur Qendra e Vizitorëve. Që nga ajo kohë, deri në Mars të vitit 2016 përmes qendrës, Kuvendin e Kosovës e kanë vizituar 453 grupe, apo gjithsej 11.937 vizitorë të grupmoshave dhe etnive të ndryshme, nga brenda dhe jashtë Kosovës. Duke pas parasysh trendin e rritjes së numrit të qytetarëve të interesuar për të vizituar Kuvendin nga viti në vit, është paraqitur nevojë për zgjerimin dhe funksionalizimin e mëtejme të qendrës së vizitorëve. Me zgjerimin e qendrës do të zhvillohen aktivitete të reja, por edhe të zgjerohen aktualet; sip sh. simulim të seancave plenare nga nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme, e cila dotuofronte njëpërvojëtë veçantë, që përmes praktikës të përjetojnë funksionimin e punëssë parlamentit. Kuvendi, në kuadër të shënimit të "Ditës së Demokracisë", çdo 15 shtator organizon
-------------------------	--

	<p>aktivitetin ditor "Dyert e hapura". Një aktivitet të tillë synon ta organizojë tre herë gjatë vitit, duke shtuar edhe 17 shkurtin për Ditën e Pavarësisë, si dhe më 1 Qershor për ditën e fëmijëve. Aktualisht, Kuvendi ka nisur me program të ri të edukimit qytetarë përmes Punëtorive për Demokraci që përfshinë nxënës nga moshat 8-15 vjeçare të shkollave fillore.</p>
Masat/Veprimet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të zgjerohet qendra e vizitorëve duke ia bashkangjitur hapësirën që gjendet afër saj (hapësirë e cila për momentin është e pashfrytëzueshme) 2. Të renovohet hapësira dhe të pajiset me inventar të nevojshëm si; karrige, tavolina etj, për të krijuar kushte për pritje të vizitorëve, takime dhe bashkëbisedime me deputetë, simulim të seancave etj. 3. Të zhvendoset në qendër zyra e zyrarit për marrëdhënie me publikun (koordinatori i njësisë). Personeli i përhershëm prej së paku dy zyrtarë. 4. Të përgatiten programe edukative-informative; historikun, aktivitetet, trupat dhe mënyrën e funksionimit, procesin ligjberës, mënyrat dhe metodat për të marrë pjesë në mbledhje, dëgjime publike, kontaktet e deputetëve dhe personelit të Kuvendit. 5. Të përgatiten broshura dhe fletëpalosje të dizajnuara për grupe të ndryshme të shoqërisë, lehtë të kuptuara për nxënës dhe fëmijë. 6. Të rishikohet dhe plotësohet programi për grupet e organizuara të vizitorëve (itinerari, qasja në hapësira të Kuvendit, pakoja me informatat dhe përfshirja aktive e zyrtarëve) 7. Të përgatitet programi dhe kalendari vjetor i aktiviteteve publike dhe caktimi i kordinatorit për aktivitete (dita e demokracisë, ditët e diasporës, dita e kushtetutës, ekspozitat e artistëve në hollin e kuvendit, etj).
Afati kohor:	2016-2018
Departamenti/Personi	Sekretari i Kuvendit

përgjegjës në Kuvend:	Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun
Organizatrat partnere:	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)

2.6. Miratimi i tekstit mbi politikën e privatësisë së të dhënave për përdoruesit e ueb-faqes së Kuvendit

Situata aktuale:	Informatat parlamentare që gjenden në faqe të Kuvendit nuk kërkojnë anëtarësim të personit për të shkarkuar ato, me ç'rast do të merreshin të dhënat personale të personit. Si pasojë, faqja e Kuvendit nuk përmban ndonjë seksion me informacion mbi politikën e privatësisë që aplikon Kuvendi.
Masat/Veprimet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të hartohet dhe miratohet një rregullore për privatësinë e përdoruesve të të dhënave të ueb-faqes së Kuvendit. 2. Të jetë e qasshme dispozita e kësaj rregullore.
Afati kohor:	2016-2017
Deparamenti/Personi përgjegjës në Kuvend:	Sekretari i Kuvendit Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun
Organizatrat partnere:	Instituti GAP, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI),

3. LLOGARIDHËNIA

Standardet etike për deputetët e Kuvendit janë parakushte të rëndësishme për ndërtimin e besimit të publikut, jo vetëm në punën e tyre të përgjithshme parlamentare, por edhe në integritetin e tyre. Në këtë aspekt, Deklarata për Parlament të Hapur parasheh që Kuvendi të miratojë rregulla të përkufizuara qartë për të siguruar zbulim të informatave të nevojshme për t'u mbrojtur nga konfliktet aktuale apo të perceptuara të interesit dhe shkeljet etike. Kuvendi gjithashtu do t'i publikojë informatat lidhur me rezultatet përfundimtare të çdo hetimi që ndërlidhet me sjelljen joetike, konfliktin e interesit apo korrupsionin. Për më tej, Pika e 23-të e Deklaratës kërkon nga Kuvendi publikimin e informatave gjithëpërfshirëse, të hollësishme dhe të kuptueshme lidhur me buxhetin shtetëror dhe shpenzimet publike, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet e kaluara, aktuale dhe të parashikuara.

Kuvendi i Kosovës ka përcaktuar qartë parimet dhe rregullat e sjelljes së deputetëve në Kodin e Mirësjelljes që është pjesë integrale e Rregullores së Kuvendit. Megjithatë, mungon një mekanizëm dhe një proces i definuar qartë për trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me shkeljet e parimeve dhe normave të etikës parlamentare. Gjithashtu, Kuvendi ka filluar të publikoj raporte më të detajuara financiare në baza 3 mujore dhe vjetore, duke ofruar kështu një pasqyrë të qartë të shpenzimeve, mirëpo, të dhënat e ofruara janë vështirë të lexueshme për qytetarët që nuk njohin procesin buxhetor dhe vështirë të përpunueshme për shkak të formatit të përdorur. Kuvendi i Kosovës synon që të rishikoj kodin e mirësjelljes dhe shqyrtimin e modaliteteve për krijimin e Komisionit për Etikë Parlamentare. Poashtu, të siguroj publikimin e rregullt dhe të qasshëm të raporteve financiare për Kuvendin dhe institucionet e agjencitë e pavarura.

3.1. Rishikimi i kodit të mirësjelljes në raport me Parimet dhe Standardet Ndërkombëtare për Etikë Parlamentare

<p>Situata aktuale:</p>	<p>Kodi i Mirësjelljes së Deputetëve është pjesë e Rregullores së Kuvendit, dhe me këtë kod përcaktohen qartë parimet dhe rregullat e sjelljes së deputeteve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre. Njëkohësisht, dispozita që ndërlidhen me çështjen e etikës janë përfshirë në Ligjin për Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve, si dhe në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Deri më tani ka pasur raste të shumta të sjelljes apo veprimeve joetike në Kuvend, duke filluar nga gjuha joparlamentare e deri te pjesëmarrja e deputetëve të caktuar në diskutim dhe votim të projektligjeve që kanë rregulluar çështje që drejtpërdrejt kanë ndikuar në bizneset e tyre personale. Për më tepër, dispozitat e kodit që parashohin regjistrimin e interesave të deputetëve në zyrën e Kryetarit të Kuvendit nuk janë zbatuar asnjëherë. Interpretimi i Rregullores së Punës është përgjegjësi e Nën-Komisionit për Rregullore, Mandate dhe Imunitet, por deri më tani nuk është trajtuar asnjë rast që ka të bëjë me etikën parlamentare. Pra, me gjithë faktin se parimet dhe normat e etikës parlamentare janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës, mungon një mekanizëm dhe një proces i definuar qartë për trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me shkeljet e parimeve dhe normave të etikës parlamentare.</p>
<p>Masat/Veprimet</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rishikimi i Kodit të Mirësjelljes, dhe azhurnimi kon form parimeve dhe normave ndërkombëtare për etikë parlamentare. 2. Shqyrtimi i modaliteteve për krijimin e Komisionit për Etikë Parlamentare. 3. Krijimi dhe publikimi i platformës për regjistrimin e interesave të deputetëve gjatë mandatit. 4. Vendosja e vegzës përkatëse të AKK (pjesës me formularët e deklaramit të pasurisë) në profilin e deputetëve në ueb faqen e Kuvendit.
<p>Afati kohor:</p>	<p>Dhjetor 2016</p>
<p>Deparamenti/ Personi përgjegjës në Kuvend:</p>	<p>Kryetari dhe Kryesia e Kuvendit Forumi për Transparencë Parlamentare Nën-Komisioni për Rregullore, Mandate dhe Imunitet Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale</p>
<p>Organizatrat partnere:</p>	<p>Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Lëvizja FOL, Instituti GAP, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI),</p>

3.2. Avancimi i transparencës buxhetore	
Situata aktuale:	<p>Përgjegjësitë e Kuvendit në përcaktimin e të hyrave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit dhe veçanërisht roli i Kuvendit në mbikëqyrjen e shpenzimit të parasë publike, e obligon atë të jetë model për të gjitha institucionet tjera sa i përket racionalitetit të shpenzimeve dhe transparencës buxhetore. Rishtazi, Kuvendi ka nisur publikimin e raporteve më të detajuara financiare në baza 3 mujore dhe vjetore, duke ofruar kështu një pasqyrë të qartë të shpenzimeve. Megjithatë, të dhënat e ofruara janë vështirë të lexueshme për qytetarët që nuk njohin procesin buxhetor dhe vështirë të përpunueshme për shkak të formatit të përdorur. Raportet financiare nuk kanë qenë unike në strukturë dhe përmbajtje gjë që e bën të vështirë krahasimin e shpenzimeve ndër vite. Gjithashtu, Kuvendi deri më tani nuk ka ofruar të dhëna që ndërlidhen me buxhetin dhe shpenzimet e institucioneve dhe agjencive të pavarura, të cilat themelohen nga Kuvendi.</p>
Masat/Veprimet	<ol style="list-style-type: none"> 1. Publikimi i rregullt i buxhetit të Kuvendit dhe raporteve periodike të shpenzimeve në një strukturë dhe përmbajtje të njejtë, që e mundëson krahasimin e shpenzimeve në mes muajve dhe viteve (publikimi i Kartelës Analitike të Kontos). 2. Publikimi i rregullt i buxhetit dhe shpenzimeve periodike dhe vjetore të institucioneve dhe agjencive të pavarura. 3. Publikimi i raporteve (apo vendosja e vegëzës) të auditorit të përgjithshëm për Kuvendin dhe institucionet e agjencitë e pavarura. 4. Ridizajnimi i raporteve në format të qasshëm dhe ofrimi i të dhënave dhe statistikave në format XML, në mënyrë që të jenë lehtë të kuptueshme.
Afati kohor:	Dhjetor2016
Deparamenti/ Personi përgjegjës në Kuvend:	Kryetari dhe Kryesia e Kuvendit Forumi për Transparencë Parlamentare Nën-Komisioni për Rregullore, Mandate dhe Imunitet Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale
Organizatrat partnere:	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti GAP, INDEP, Lëvizja FOL, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)

4. AVANCIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Përdorimi i teknologjisë informative për ofrimin e të dhënave është mënyra më e mirë dhe më e lehtë e hapjes së Kuvendit. Në shumë raste nuk mjafton që informatat të bëhen transparente në çfarëdo forme, por ato duhet të jenë të qasshme në format të përpunueshëm. Mënyra e "të dhënave të hapura (open data) është mënyra më e mirë për të bërë transparente të dhënat e Kuvendit, sepse transparenca duhet t'u shërbej qytetarëve dhe organizatave për të kërkuar llogaridhënie. Pa patur mundësi të përpunohen të dhënat, është vështirë të nxirret një pasqyrë e kuptueshme e punës së Kuvendit.

Informatat/dokumentet parlamentare në faqen zyrtare të Kuvendit janë kryesisht në formatin PDF, dhe vështirë procesohen nga përdoruesit (qytetarët, shoqëria civile etj). Transkriptet, procesverbalet, revista e Kuvendit, buletini, dhe seksioni i dokumenteve në faqe të parlamentit janë të gjitha PDF. Për qasje në dokumente tjera, duhet bërë kërkesë për qasje në dokumente publike, të cilat nëse vihen në dispozicion, ipen si "hard copy" dhe përdorimi i tyre është i vështirë. Po ashtu, në faqen zyrtare të Kuvendit nuk ka ndonjë bazë të të dhënave nga ku mund të shkarkohen të dhëna, përveç listimit të ligjeve sipas emrit, datës, projektligjeve, evidenca e ligjeve të miratuara, të cilat nuk janë lehtë të qasshme për shkak se gjenden në vende të ndryshme nëpër faqe. Megjithatë, kjo faqe bën një "azhurnim" të informatave sa i përket ballinës, d.m.th. takimeve të Kryetarit të Kuvendit, orarit të mbledhjeve të komisioneve, orarit dhe agjendës së seancave parlamentare, etj.

Kuvendi i Kosovës synon të avancoj teknologjinë informative në përgjithësi. Në Mars të 2016 ka arritur marrëveshje dhe është në proces të ridizajnit të ueb-faqes me "responsive web design", proces në të cilin kanë ftuar edhe pjesëmarrjen e OSHC-ve. Poashtu, do të funksionalizohet E-parlamenti së bashku me arkivë elektronike, si dhe ristrukturimi i tërë databazës për të mundësuar qasje intuitive. Kuvendi parasheh që të rishikoj edhe analizën e mundësisë për kalimin në "Cloud" dhe të përdorimit të "open source" në rastet ku mund të aplikohet konform kërkesave teknologjike, si dhe Krijimin e platformës për E-pjesëmarrje.

4.1 Funkcionalizimi i plotë i platformës së “E-parlamentit” dhe zhvillimi i databazës online i shënimeve origjinale të Kuvendit (e-parlamenti me arkivë elektronike)

<p>Situata aktuale:</p>	<p>Platforma e-parlament është implementuar teknikisht në tërësi, sipas kërkesës. Mirëpo, kanë mbetur vetëm disa pjesë të integritit të ueb TV dhe audio/video për të cilat Kuvendi ende nuk është gati. Pas publikimit të urdhëresës për publikim, pritet intensifikim i punëve të stafit përgjegjës dhe popullimi i sistemit me të dhëna për përdorim të mëtutjeshëm.</p> <p>Databaza dhe backup-i janë krijuar në tërësi, dokumentet nga e-parlament ruhen në mënyrë të vazhdueshme, në të ardhmen duhet implementuar projekti i arkivimit elektronik.</p>
<p>Masat/Veprimet:</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të inkurajohet stafi nga njësitëe ndryshme që të ndajnë informata dhe të përfshijnë kolegët tjerë në proceset e njësisë. 2. Të integrohet me aplikacione tjera ekzistuese dhe ato potenciale në të ardhmen. 3. Implementimi i urdhëresës për publikim në tërësi. 4. Të sigurohet pjesëmarrja e tërë stafit relevant në implementim. 5. Pas implementimit të projektit për arkivim elektronik, duhet të arkivohen edhe dokumentet e vjetra në mënyrë retroaktive.
<p>Afati kohor:</p>	<p>2016 - 2020</p>
<p>Departament/Personi përgjegjës në Kuvend:</p>	<p>Administrata e Kuvendit Sekretari i Kuvendit</p>
<p>Organizatrat partnere:</p>	<p>Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti GAP</p>

4.2 Ri-dizajnimi i uebfaqes së Kuvendit me "Responsive Web Design" dhe funksionalizimi i sistemit të integruar për incizime dhe emetim (web-casting) audio/video të seancës plenare, mbledhjeve të komisioneve dhe aty ku mund të aplikohet;

<p>Situata aktuale:</p>	<p>Informatat parlamentare që gjenden në faqe të internetit të Kuvendit janë të shpërndara në shumë pjesë, edhe pse nën një URL (www.kuvendikosoves.org). Nuk ka lidhje të informatave me informatën tjetër përkatëse. Pavarësisht se sa dokumente/informata kanë lidhje njëra me tjetrën dhe ekziston nevoja që të gjitha të jenë me lidhje përmes vegëzave (linqeve). Kuvendi aktualisht ka ndërmarrë hapa në këtë drejtim dhe punët preliminare veç kanë filluar.</p> <p>Vetëm për sallën plenare ka infrastrukturë teknologjike për të filluar ueb streaming (emetim i drejtpërdrejtë i seancave plenare në ueb faqen e Kuvendit) dhe është e paraparë edhe me kontratë për redizajnim të ueb faqes. Implementimi do të bëhet në fillim të sesionit vjeshtor 2016. Një sistem i integruar për përkrahje Audio/Video, emetim, incizim dhe arkivim duhet të projektohet dhe implementohet sa më parë që është e mundur.</p>
<p>Masat/Veprimet:</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e planit të veprimit dhe implementimit të dizajnit të ri për çdo fazë. 2. Vendosja e një procedure tre-hapeshe për sqarim dhe aplikim/kërkim të një dokumenti publik (i cili nuk është në ueb faqe). 3. Implementimi i procedurës trehapëshe menjëherë pas diskutimit dhe miratimit të dokumenteve dhe hapave konkret (sipas rregullativës ligjore). 4. Të caktohet dhe publikohet personi në Kuvend që është i ngarkuar me punën, përgjegjës në kërkesa për dokumente publike - sipas ligjit. 5. Takime me palë të interesuara për dizajn dhe funksionalitete të reja 6. Diskutime me prototip të ueb faqes së ridizajnuar deri në miratim dhe publikimi i funksionaliteteve të reja. 7. Përpilimi i projekt propozimit me funksionalitete të reja të cilat dalin pas diskutimeve dhe që nuk janë të parapara me kontratën initiale.

	<p>7. Përpilimi i projekt propozimit me funksionalitete të reja të cilat dalin pas diskutimeve dhe që nuk janë të parapara me kontratën iniciale.</p> <p>8. Të merret mendimi i OSHC lidhur me ueb faqen gjatë redizajnit.</p> <p>9. Drejtoria e TI-se me ndihmën e projektit të binjakëzimit dhe eventualisht me vizita studimore në parlamentet tjera, deri në fillim të sesionit vjeshtor 2016 duhet të hartoj projektin - planin për një sistem të integruar.</p> <p>10. Implementimi i projektit në tërësi përveç vullnetit politik (Video incizimet në mbledhje të komisioneve etj.) kërkon edhe mjete buxhetore të konsiderueshme.</p>
Afati kohor:	2016 - 2020
Departament/Personi përgjegjës në Kuvend:	Kryesia e Kuvendit Sekretari i Kuvendit Drejtoria e Teknologjisë Informative
Organizatrat partnere:	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti GAP

4.3. Ri-strukturimi i tërë databazës (ueb faqes) dhe të mundësohet qasje intuitive në përmbajtje	
Situata aktuale:	Ri-strukturimi i databazës është e përfshirë në kontratë për ridizajnim dhe do të punohet paralelisht në këtë drejtim, duke punuar në ridizajnimin grafik dhe teknologjik të ueb faqes (për responsive web design).
Masat/Veprimet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të bëhet ristrukturimi hap pas hapi në disa faza. 2. Diskutim i gjerë me persona relevant në Kuvend dhe jashtë Kuvendit (me propozime konkrete dhe të argumentuara) mbi analizën e gjendjes dhe rekomandime për zbatim. 3. Të merret parasysh edhe puna paralele edhe me sistemin e-parlament dhe strukturën që është e gatshme për përdorim. 4. Çdo shtesë e mundshme me buxhetim nga donatorë të mundshëm (ndonjë pilot projekt për ndonjë funksionalitet të ri në ueb faqe) duhet të merret në konsideratë dhe të financohet drejtpërdrejtë te kompania e cila teknikisht e ridizajnon ueb faqen, kurse për përmbajtje diskutohet në Kuvend.
Afati kohor:	2016-2020
Deparatment/Personi përgjegjës në Kuvend:	Sekretari i Kuvendit Drejtorja e Teknologjisë Informative
Organizatrat partnere:	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti GAP

4.4. Analiza e mundësisë edhe për kalimin në "Cloud" dhe të përdorimit të "open source" në rastet ku mund të aplikohet konform kërkesave teknologjike

<p>Situata aktuale:</p>	<p>Analiza është bërë për një pjesë të shërbimeve (dokument / raport në drejtorinë e TI-së) dhe duhet të bëhet edhe për shërbime të Audio/Videopërkrahjes, incizimit, emetimit (streaming) dhe arkivimit elektronik të përmbajtjeve Audio/Video që të gjitha të bëhen në 'cloud' me përkrahje të Microsoft. Gjendja e gatishmërisë teknologjike në Kuvend është e plotë - mbetet vetëm pranimi dhe miratimi konceptual i situatës kur dokumentet e Kuvendit do të jenë në 'cloud' (shembuj të parlamenteve që kanë kaluar 100% në cloud ka shumë dhe i kemi në dispozicion për argumentim).</p> <p>Aktualisht, Kuvendi përdorë 'open source' në tërë platformën e ueb faqes zyrtare (të jashtme), e cila plotësisht është e ndërtuar në Linux, php, mysql etj.</p>
<p>Masat/Vepimet:</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të diskutohet më gjerë projekt propozimi. 2. Miratimi në parim nga strukturat më të larta në Kuvend. 3. Zbatimi nga drejtoria e TI-së dhe Microsoft (pasi që një marrëveshje preliminare ka filluar në parim). 4. Gjatë planifikimit të sistemeve të reja duhet të aplikohet dhe merret parasysh mundësia e përdorimit të softuerëve 'open source' në vend të Microsoft (edhe pse për MS Kuvendi ka kontratë shtetërore me Microsoft). 5. Një pilot sistem për aplikim të 'open source' është sistemi i informimit përmes monitorëve - Kuvendi ka nevojë për shtimin e numrit të monitorëve dhe /ose ndryshimin e pozicioneve si dhe të sistemit operativ dhe aplikacioneve (të cilat tani mund të bëhen edhe në 'open source' platformë).
<p>Afati kohor:</p>	<p>2016-në vazhdimësi</p>
<p>Deparatment/Personi përgjegjës në Kuvend:</p>	<p>Sekretari i Kuvendit Drejtoria e Teknologjisë Informative</p>
<p>Organizatata partnere:</p>	<p>Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti GAP</p>

4.5. Krijimi i platformës për e-pjesëmarrje, dhe rregullimi me një Rregullore të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës

Situata aktuale:	Krijimi i platformës për e-pjesëmarrje është pjesë e kontratës për e-parlament (vetëm si analizë). Megjithatë, ka tri vite që ka filluar implementimi për e-parlamentin dhe nuk është arritur një platformë e mirë për këtë.
Masat/Veprimet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të analizohet dhe rregullohet ligjërisht ky aktivitet. 2. Të shikohen mundësitë përmes donatorëve që ky funksionalitet teknologjik të inkorporohet në ueb faqe dhe në e-parlament. 3. Të fillohet me një pilot / projekt (një ide ka filluar tashmë përmes UNDP). Nëse ka qëndrueshmëri - të vazhdohet dhe të inkorporohet në sistemet ekzistuese të TI-së në Kuvend.
Afati kohor:	2016-2018
Deparatmet/Personi përgjegjës në Kuvend:	Drejtoria e Teknologjisë Informative
Organizatrat partnere:	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti GAP

Publikimi i këtij dokumenti është mundësuar me mbështetjen e popullit zemërgjerë amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e USAID dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
ODAMERIČKOGNARODA

